



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2025

PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT: “Blerje karburanti për
nevojat e Bashkisë Divjakë” Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të
gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj

I mbajtur sot, më datë _____.____.2025, nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Divjakë” Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit: 33 358 555 (tridhjetë e tre milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh, nga e cila: 31 766 020 (tridhjetë e një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëzet) lekë pa Tvsh për Naftë dhe 1 592 535 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa Tvsh për Benzinë, i ndarë si më poshtë:

Vlera e fondit limit ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte

336 717 (treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 13.02.2025 12:34:45 eshte 99.07

Mjetet e Bashkisë Divjakë:

- 14 061 520 (katërmëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzetë) lekë pa Tvsh për **Naftë** (Kodi i programit 01110 ,Grupi 00 ,Llogaria ekonomike 602 ,kodi projektit 9999999)
 - **Kapitulli 01** -11 416 667 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) leke pa Tvsh .
 - **Kapitulli 05** - 2 644 853 (dy milion e gjashtëqind e dyzet e katërmijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre) leke pa Tvsh .

Vlera e fondit limit per Mjetet e Bashkisë Divjakë ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 141 935 (njqind e dyzet e nje mije e nenteqind e tridhjetë e pese) euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro date 13.02.2025 12:34:45 eshte 99.07

Për Sektorin e turizmit:

- 941 340 (nëntëqind e dyzet e një mijë e treqind e dyzet) lekë pa Tvsh për **Benzinë** (Kodi i programit 04130 Grupi 00 ,Llogaria ekonomike 602 ,kodi projektit 9999999)
 - **Kapitulli 01** - 750 000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) leke pa Tvsh .

- **Kapitulli 05** -191 340 (njëqind e nëntëdhjetë një mijë e treqind e dyzet)
lekë pa Tvsh

Vlera e fondit limit per Sektori Turizmit ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 9 502 (nente mije e peseqind e dy) euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 13.02.2025 12:34:45 eshte 99.07

Agjensinë e Shërbimeve Komunale, Bashkia Divjakë:

- 9 889 000 (nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntëmijë) lekë pa Tvsh (**Kodi i programit 06260 Grupi 00 ,Llogaria ekonomike 602 ,kodi projektit 9999999**), nga e cila:
 - 9 657 000 (nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatëmijë) lekë pa Tvsh për **Naftë:**
 - **Kapitulli 01** - 7 333 333(shtatëmilion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh .
 - **Kapitulli 05** - 2 323 667 (dymilion e treqind e njëzet e tremijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh
 - 232 000 (dyqind e tridhjetë e dy mijë) lekë pa Tvsh për **Benzinë**
 - **Kapitulli 05** - 232 000 (dyqind e tridhjetë e dy mijë) lekë pa Tvsh

Vlera e fondit limit per Agjensinë e Shërbimeve Komunale, Bashkia Divjakë ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 99 818 (nentedhjete e nente mije e teteqind e tetembedhjete) euro pa tvsh.Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 13.02.2025 12:34:45 eshte 99.07

Drejtoria e Infrastrukturës ,Sektori Ujitje- Kullim:

- 6 090 000 (gjashtë milion e nëntëdhjetë mijë) lekë pa Tvsh ,nga e cila:
 - 5 800 000 (pesë milion e tetëqind mijë) lekë pa Tvsh për **Naftë** (**Kodi i programit 04240, Grupi 00 ,Llogaria ekonomike 602 ,kodi projektit 9999999 ,kapitulli 01**)
 - 290 000 (dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa Tvsh për **Benzinë** (**Kodi i programit 04240, Grupi 00 ,Llogaria ekonomike 602 ,kodi projektit 9999999 ,kapitulli 01**)

Vlera e fondit limit per Drejtorinë e Infrastrukturës, Sektori Ujitje - Kullim ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 61 472 (gjashtedhjete e nje mije e katerqind e shtatedhjete e dy) euro pa tvsh.Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 13.02.2025 12:34:45 eshte 99.07

Drejtoria e Infrastrukturës ,Sektori i Rrugëve Rurale:

- 1 116 500 (një milion e njëqind e gjashtmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh për Naftë (Kodi i programit 04520 Grupi 00 ,Llogaria ekonomike 602 ,kodi projektit 9999999 ,kapitulli 01)

Vlera e fondit limit per Drejtorinë e Infrastrukturës, Sektori i Rrugëve Rurale ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 11 270 (njembedhjetë mijë e dyqind e shtatedhjetë mijë) euro pa tvsh.Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 13.02.2025 12:34:45 eshte 99.07

Sektori i MZSH-së:

- 1 170 150 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh (Kodi i programit 03280 ,Grupi 00 ,Llogaria ekonomike 602 ,kodi projektit 9999999 ,kapitulli 01), nga e cila:
 - 1 131 000 (një milion e njëqind e tridhjetë e njëmijë) lekë pa Tvsh për Naftë
 - 39 150 (tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh për Benzinë

Vlera e fondit limit për Sektorin e MZSH-së ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 11 811 (njembedhjetë mijë e teteqind e njembedhjetë) euro pa tvsh.Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 13.02.2025 12:34:45 eshte 99.07

Drejtorinë e Bujqësisë, Mjedisit,Veterinarisë dhe Pyjeve:

- 90 045 (nëntëdhjetë mijë e njëzetë e pesë) lekë pa Tvsh (Kodi i programit 04260 ,Grupi 00 ,Llogaria ekonomike 602 ,kodi projektit 9999999 ,kapitulli 01)

Vlera e fondit limit për Drejtorinë e Bujqësisë, Mjedisit,Veterinarisë dhe Pyjeve ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 909 (nenteqind e nente) euro pa tvsh.Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 13.02.2025 12:34:45 eshte 99.07

Burimi i financimit: Granti + Të ardhurat

- 27 966 695 (njëzet e shtatë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh nga Granti, nga e cila: 26 797 500 (njëzetë e gjashtë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh për Naftë dhe 1 169 195 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e një qind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh për Benzinë.
- 5 391 860 (pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat, nga e cila: 4 968 520 (katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa Tvsh për Naftë dhe 423 340 (katër qind e njëzet e tre mijë e treqind e dyzet) lekë pa Tvsh për Benzinë.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një

përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Referuar Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në zbatim të neneve të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me të njëjtën familje mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori.

Në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së i ndryshuar, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së i ndryshuar, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër, legjislacioni i prokurimit publik, njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte furnizimin e kërkuar i cili nuk mund të copëzohet. Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Theksojmë se kjo procedurë është një procedurë e cila realizohet në mënyrë të përvitshme nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë dhe për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash, ndër vite është është realizuar e përqendruar në një kontratë.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT